



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:204504

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05519603

C.nr.1459/2021

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Leart Rexhaj, me bashkëpunëtoren profesionale Shqipe Sejdiu, në çështjen juridike kontestimore të paditësve N.D, F.M, L.B, A.A dhe R.Rr nga M, të cilët i përfaqëson sipas autorizimit av.L.A, avokat në Mitrovicë, kundër të paditurës K.M-DKA, me seli në M, me objekt kontesti: Kompensimi i shujtës ushqimore dhe kompensimi i përqindjes së inflacionit në pagë, jashtë seance, me datë 28.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET NË TËRËSI SI E BAZUAR kërkesëpadia për kompensimin e shujtës ushqimore dhe kompensimit në emër të inflacionit në pagë, e paditësve N.D, F.M, L.B, A.A dhe Remzi Rrahmani, nga M, DETYROHET e paditura K.M-DKA, që paditësve, në emër të kompensimit te shujtave ditore për periudhën kohore 12.03.2020 deri më 30.12.2020 si dhe në emër të inflacionit në pagë për periudhën kohore prej datës 04.04.2019 deri më 30.12.2020, t'ia kompensoj shumat si në vijim:

a). Paditëses N.D, për periudhën 12.03.2020 deri 30.12.2020 në emër të shujtës ushqimore, gjithsej për 13 ditë pune në shumën prej 26.00 euro, ndërsa në emër të inflacionit në pagë për periudhën nga data 04.04.2019, e deri me datë 30.12.2019, t'ia paguajë shumën prej 103.30 Euro, dhe për periudhën nga data 01.01.2020, e deri me datë 30.12.2020, t'ia paguajë shumën prej 10.20 Euro.

b). Paditëses F.M, për periudhën 12.03.2020 deri 30.12.2020, gjithsej për 70 ditë pune në shumën prej 140.00 euro, ndërsa në emër të inflacionit në pagë për periudhën nga data

04.04.2019, e deri me datë 30.12.2019, t'ia paguajë shumën prej 117.89 Euro, dhe për periudhën nga data 01.01.2020, e deri me datë 30.12.2020, t'ia paguajë shumën prej 11.64 Euro.

c). Paditësit L.B, për periudhën 12.03.2020 deri 30.12.2020, gjithsej për 69 ditë pune në shumën prej 138.00 euro, ndërsa në emër të inflacionit në pagë për periudhën nga data 04.04.2019, e deri me datë 30.12.2019, t'ia paguajë shumën prej 115.04 Euro, dhe për periudhën nga data 01.01.2020, e deri me datë 30.12.2020, t'ia paguajë shumën prej 11.36 Euro.

d). Paditëses A.A, për periudhën 12.03.2020 deri 30.12.2020, gjithsej për 70 ditë pune në shumën prej 140.00 euro, ndërsa në emër të inflacionit në pagë për periudhën nga data 04.04.2019, e deri me datë 30.12.2019, t'ia paguajë shumën prej 118.37 Euro, dhe për periudhën nga data 01.01.2020, e deri me datë 30.12.2020, t'ia paguajë shumën prej 11.69 Euro.

e). Paditësit R.Rr, për periudhën 12.03.2020 deri 30.12.2020, gjithsej për 39 ditë pune në shumën prej 78.00 euro, ndërsa në emër të inflacionit në pagë për periudhën nga data 04.04.2019, e deri me datë 30.12.2019, t'ia paguajë shumën prej 56.07 Euro, dhe për periudhën nga data 01.01.2020, e deri me datë 30.12.2020, t'ia paguajë shumën prej 5.53 Euro.

II. Për secilin paditës veç e veç me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e parashtrimit të padisë 14.09.2021 e deri në pagesën definitive si dhe detyrohet e paditura që paditësve t'ua paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 332,00 euro, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësit N.D, F.M, L.B, A.Adhe R.Rr nga M, përmes të autorizuarit të tyre, pranë kësaj gjykate me datë 14.09.2021, kanë parashtruar padi të cilën padi edhe e kanë precizuar kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensimi në emër të shujtës ushqimore, si dhe kompensimi i shkallës së inflacionit të pa paguar në pagë. Në padi kanë theksuar se paditësit janë të punësuar pranë të paditurës. Tutje kanë theksuar se paditëseve nuk i'u është bërë kompensimi në emër të shujtës ushqimore dhe kompensimi për inflacion në pagë. Në padi dhe precizimin e saj paditësit kundër të paditurës K.M-DKA, kanë kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësve në emër të kompensimit për shujtën ushqimore t'ia kompensoj paditëses N.D, për periudhën 12.03.2020 deri 30.12.2020 në emër të shujtës ushqimore, gjithsej për 13 ditë pune në shumën prej 26.00

euro, ndërsa në emër të inflacionit në pagë për periudhën nga data 04.04.2019, e deri me datë 30.12.2019, t'ia paguajë shumën prej 103.30 Euro, dhe për periudhën nga data 01.01.2020, e deri me datë 30.12.2020, t'ia paguajë shumën prej 10.20 Euro; paditëses F.M, për periudhën 12.03.2020 deri 30.12.2020, gjithsej për 70 ditë pune në shumën prej 140.00 euro, ndërsa në emër të inflacionit në pagë për periudhën nga data 04.04.2019, e deri me datë 30.12.2019, t'ia paguajë shumën prej 117.89 Euro, dhe për periudhën nga data 01.01.2020, e deri me datë 30.12.2020, t'ia paguajë shumën prej 11.64 Euro; paditësit L.B, për periudhën 12.03.2020 deri 30.12.2020, gjithsej për 69 ditë pune në shumën prej 138.00 euro, ndërsa në emër të inflacionit në pagë për periudhën nga data 04.04.2019, e deri me datë 30.12.2019, t'ia paguajë shumën prej 115.04 Euro, dhe për periudhën nga data 01.01.2020, e deri me datë 30.12.2020, t'ia paguajë shumën prej 11.36 Euro; paditëses A.A, për periudhën 12.03.2020 deri 30.12.2020, gjithsej për 70 ditë pune në shumën prej 140.00 euro, ndërsa në emër të inflacionit në pagë për periudhën nga data 04.04.2019, e deri me datë 30.12.2019, t'ia paguajë shumën prej 118.37 Euro, dhe për periudhën nga data 01.01.2020, e deri me datë 30.12.2020, t'ia paguajë shumën prej 11.69 Euro; paditësit R.Rr, për periudhën 12.03.2020 deri 30.12.2020, gjithsej për 39 ditë pune në shumën prej 78.00 euro, ndërsa në emër të inflacionit në pagë për periudhën nga data 04.04.2019, e deri me datë 30.12.2019, t'ia paguajë shumën prej 56.07 Euro, dhe për periudhën nga data 01.01.2020, e deri me datë 30.12.2020, t'ia paguajë shumën prej 5.53 Euro; për secilin veç e veç me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e parashtrimit të padisë, si dhe i kanë kërkuar shpenzimet e procedurës.

E paditura përmes përgjigjes në padi e ka pohuar kërkesëpadinë e paditësve sa i përket kompensimit të shujtave dhe ka theksuar se paditësit e lartcekur me provat e bashkëngjitura padisë kanë dëshmuar ditët e pranisë në punë për periudhën kohorë gjatë të cilës ka kërkuar kompensimin e shujtës ushqimore, ndërsa e kanë kontestuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve sa i përket inflacionit në pagë sa i përket periudhës janar 2020 për arsye se gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur inflacion në pagë; po ashtu e paditura i ka kundërshtuar edhe shpenzimet e procedurës. I kanë propozuar gjykatës që kërkesëpadia e paditëseve të aprovohet pjesërisht e bazuar për shkak të pretendimeve të lartcekura.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e provave të bashkëngjitura padisë, si dhe pas pranimin të përgjigjes në padi, mbështetur në nenin 8 dhe 398 të LPK-së, ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vlerësimi i përgjigjes në padi, gjykata konstatoi se: në mes palëve ndërgjyqësve nuk është kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, konkretisht në SH.M.L e Mjekësisë “Dr.Xh.D” në Mitrovicë, ndërsa nga provat tjera të bashkangjitur padisë vërtetohet këto fakte:

Nga vërtetimi i lëshuar nga SH.M.L e Mjekësisë “Dr.Xh.D” në Mitrovicë, me nr.protokolli 409, i datës 13.10.2023, në emër të paditëses N.D, vërtetohet fakti se paditëja është e punësuar pranë të paditurës dhe prej periudhës 12.03.2020 deri me datë 30.12.2020, ka gjithsej 13 ditë pune. Ndërsa nga lista e pagës vërtetohet fakti se paditësja ka realizuar pagë mujore ne lartësi prej 425.11 euro.

Nga vërtetimi i lëshuar nga SH.M.L e Mjekësisë “Dr.Xh.D” në Mitrovicë, me nr.protokolli 440, i datës 13.10.2023, në emër të paditëses F.M, vërtetohet fakti se paditësi është i punësuar pranë të paditurës dhe prej periudhës 12.03.2020 deri me datë 30.12.2020, ka gjithsej 70 ditë pune. Ndërsa nga lista e pagës vërtetohet fakti se paditësi ka realizuar pagë mujore ne lartësi prej 485.16 euro.

Nga vërtetimi i lëshuar nga SH.M.L e Mjekësisë “Dr.Xh.D” në Mitrovicë, me nr.protokolli 424, i datës 13.10.2023, në emër të paditësit L.B, vërtetohet fakti se paditësja është e punësuar pranë të paditurës dhe prej periudhës 12.03.2020 deri me datë 30.12.2020, ka gjithsej 69 ditë pune. Ndërsa nga lista e pagës vërtetohet fakti se paditësja ka realizuar pagë mujore ne lartësi prej 473.42 euro.

Nga vërtetimi i lëshuar nga SH.M.L e Mjekësisë “Dr.Xh.D” në Mitrovicë, me nr.protokolli 412, i datës 13.10.2023, në emër të paditëses Arsia Aliqi, vërtetohet fakti se paditësja është e punësuar pranë të paditurës dhe prej periudhës 12.03.2020 deri me datë 30.12.2020, ka gjithsej 70 ditë pune. Ndërsa nga lista e pagës vërtetohet fakti se paditësi ka realizuar pagë mujore ne lartësi prej 487.12 euro.

Nga vërtetimi i lëshuar nga SH.M.L e Mjekësisë “Dr.Xh.D” në Mitrovicë, me nr.protokolli 456, i datës 13.10.2023, në emër të paditësit Remzi Rrahmani, vërtetohet fakti se paditësja është e punësuar pranë të paditurës dhe prej periudhës 12.03.2020 deri me datë 30.12.2020, ka gjithsej 39 ditë pune. Ndërsa nga lista e pagës vërtetohet fakti se paditësi ka realizuar pagë mujore ne lartësi prej 230.77 euro.

Ndërsa nga indeksi i harmonizuar çmimeve te konsumit konstatohen ndryshimet mujore dhe vjetore te çmimeve ne përqindje: inflacioni për vitin 2019 është 2.7%, ndërsa për vitin 2020 është 0.02 %.

Në padi është ngritur pretendimi se paditëset nuk kanë pranuar kompensimin e shtesave në pagë-inflacion për vitet 2019 dhe 2020 pasi qe mbështetje te nenin 35 par 10 te KKAK – së, parashihet qe “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”. Nga interpretimi i kësaj dispozite, gjykata vlerëson se e njëjta dispozitë është detyruese për të paditurën andaj edhe e ka detyruar të njëjtën që pjesërisht paditëseve ti kompensoj kërkesat lidhur me kompensimin e shtesave në pagë-inflacionit për periudhën kohore të cekur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kundërshtimi i të paditurës, lidhur me kompensimin në pagë në emër të inflacionit për periudhën janar 2020, për arsye se gjatë kësaj periudhe kohore nuk ka pasur inflacion në pagë sipas statistikave të Entit të Statistikave të Kosovës, nuk qëndron për arsye se inflacioni në pagë nuk llogaritet për muaj por llogaritet për vite, andaj edhe në këtë kuptim inflacioni për vitin 2020 ka qenë 0,02%, e po ashtu ka qenë fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit, e cila sipas Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme nr.40/2023, i datës 27.02.2023, në pikën IV (katër) ka përcaktuar se: *“Kontrata Kolektive e Arsimit e lidhur me datë 18.04.2017, aplikohet në periudhën kohore nga data 18.04.2017, e deri me datë 21.01.2021”*.

Nga të lartcekurat, gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit aprovues jashtë seance, në kuptim të nenit 398 i LPK-së, sipas të cilit *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*. Duke qenë se ka lindur e drejta e paditëseve për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës për kompensimin e shtesave ne page-inflacionit e njëjta është legjitimuar që të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura, së këndejmi, paditëset e kane rolin e kreditorit, kurse e paditura rolin e debitorit. Në kuptim të nenit 245 të Ligjit nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*.

Lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8%, gjykata vendosi si ne piken II te dispozitivit te këtij aktgjykimi e ne mbështetje të nenit 382 të LMD-së, sipas të cilit *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”*, e llogaritur nga dita e paraqitjes se padisë te datës 14.09.2021.

Gjykata ne mbështetje te nenit 452 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ashtu që detyrohet e paditura të paguaj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 312 për përpilimin e padisë- sipas tarifës së OAK, si dhe në emër te taksës gjyqësore shumen prej 20.00 euro.

Gjykata, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke i’u referuar dispozitës së nenit 8,398, dhe 452 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROIVCË

Departamenti i përgjithshmen-Divizioni civil

C.nr.1459/2021, datë 28.03.2024

Gjyqtari,
Leart Rexhaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.